



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 23.12.2008 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N.225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Fatmire Berisha, Adem Hajdaraj, Donika Kadaj-Bujupi, Heset Cakolli, Memli Krasniqi, Gani Buçinca, Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Monitorimi i zbatimit të ligjeve,**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 17.12.2008 pa vërejtje.

2. Monitorimi i zbatimit të ligjeve

Agim Veliu, kryetar lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se nga strategjia legislative e Qeverisë për vitin 2008 janë miratuar disa projektligje nga ana e Komisionit.

Komisioni në mbledhjen e kaluar ka kërkuar të sigurohet lista e ligjeve të miratuara në mënyrë që të fillohet me monitorimin e zbatimit të ligjeve që janë në kompetencë të tij, të përcaktohem se në çfarë forme të bëhet monitorimi dhe cilat ligje kërkojnë prioritet në këtë aspekt.

Në vijim diskutuan anëtarët e Komisionit.

Heset Cakolli tha se ekziston një numër i konsiderueshëm i ligjeve të miratuara dhe se secili ka rëndësinë e vet. Ne si Komision do duhej të organizohemi për monitorim të ligjeve në praktikë me qëllim të marrjes së informatave për zbatimin e tyre. Në këtë aspekt ai përmendi Ligjin për Arsimin e Lartë si dhe Ligjin për Veprimtaritë Kërkimore Shkencore si ligje të rëndësishme të veçantë kanë të cilat duhet të monitorohen dhe ku do të jepte kontributin e tij.

Adem Hajdaraj lidhur me këtë tha se ligjet duhet të monitorohen në tërësi nga i gjithë Komisioni dhe me këtë rast do duhej ti ipej prioritet disa ligjeve. Si shembull përmendi Ligjin për inspektionin e arsimit, Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta ku mendon se ka shume shmangje në botimin e librave.

Gjithashtu në këtë aspekt ai mendon se duhet monitorohet edhe Ligji për sportin në mënyrë që të shiqohet zbatimi i tij në praktikë.

Fatmire Berisha tha se ligjet e miratuara pavarësisht nga cila legjislatore kanë një rëndësi të madhe dhe se disa nga to kërkojnë një monitorim më të përshtetshëm. Shembull në këtë rast përmendi ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm si dhe Ligjin për provimin përfundimtar dhe të maturës. Më tej mendon se Komisioni duhet të hartojë një listë prioritare të monitorimit të ligjeve dhe që monitorimi të bëhet nga anëtarët e Komisionit bashkarisht.

Drita Kadriu mendon se një projekt plan i veprimit të punëve do t'i shërbente Komisionit me qëllim të koordinimit të punëve veqmas në çështjen e monitorimit të ligjeve të miratuara. Ajo mendon se draftin të cilin e ka përgatitur për Komisionin do duhej debatuar në mbledhjen e ardhshme me qëllim të organizimit të punëve të caktimit të aktiviteteve të anëtarëve të Komisionit.

Sa i përket mënyrës së monitorimit mendon se ajo do duhej bërë nga grupe të vogla punuese varësisht nga rëndësia dhe e jo në tërësi si Komision.

Donika Kadaj Bujupi mendon se për fillimin e monitorimit të ligjeve duhet patur planin e veprimit të detajuar, si dhe agjendën e ligjeve të cilat janë prioritet. Për këtë çështje ajo mendon se duhet vendosur kriteret se në cilat sfera zbatohet ligji dhe në cilat ka ngecje në implementim dhe se ndarja në grupe punuese në këtë aspekt do të kontribuonte në monitorim të ligjeve.

Gani Buçinca vlerëson se duhet krijuar prioritetet se cilat ligje do të monitorohen, në këtë aspekt do të kontribuonte edhe mbajtja e dëgjimeve publike. Ai propozon që të hartohet një plan operativ nga kryetari i Komisionit dhe më pas të fillohet me prioritetet.

Agim Veliu, kryetar, lidhur me këtë konstatoi se Komisioni duhet të hartojë planin e punës për vitin e ardhshëm dhe me këtë rast kërkoi nga anëtarët e Komisionit të hartojnë dhe propozojnë projekt plane në mënyrë që të vendosim se në qfarë forme ti qasemi çështjes së monitorimit të ligjeve bashkarisht si Komision apo në grupe punuese për ligje të veçanta.

Propozimi për hartim të planit të punës u përkrah nga anëtarët e Komisionit.

3. Të ndryshme

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me kërkesën e një grupi studentësh nga Asociacioni i të diplomuarve në IPAL drejtuar Komisionit me qëllim të hapjes së debatit në Kuvend për vazhdimin e studimit master në UP të diplomuarve në Institucionet private të arsimit.

Lidhur me këtë kërkesë diskutuan anëtarët e Komisionit.

Donika Kadaj- Bujupi mendon se debatet duhej të përcillen në çdo shoqëri demokratike dhe lidhur me këtë kërkesë mendon se do duhet mbajtur debat në Kuvend.

Adem Hajdaraj lidhur me këtë kërkesë mendon se Komisioni vetëm mund t'i drejtohet me rekomandim Qeverisë, me këtë rast konsideron se nuk është çështje e Komisionit të inicijojë mbajtjen e debatit në Kuvend lidhur me këtë çështje.

Memli Krasniqi mendon se për të hapur debat në Kuvend për çdo çështje apo kërkesë që i adresohet Komisionit nga qytetarët është e tepërt dhe e pa nevojshme. Kërkesat e tilla duhet shqyrtuar nga Komisioni në këtë rast, mendon se procesi i akreditimit do ta zgjidhte çështjen e kësaj kërkese të studentëve.

Heset Cakolli, konsideron se kërkesa e studentëve të IPAL është legjitime dhe si e tillë çështje e brendshme e Universitetit dhe Institucioneve Private të Arsimit e që duhet rregulluar me ligj.

Gani Buçinca është kundër mbajtjes së debateve në Kuvend për kërkesa të tilla. Ai konsideron se kjo çështje është dashur t'i adresohet Qeverisë respektivisht Ministrisë, dhe kjo duhet rregulluar me Ligjin për Arsimin e Lartë.

Mark Krasniqi, kërkesën e parashtruar nga Asociacioni i studentëve të arsimit privat e konsideron jo serioze ngase si e tillë është e nënshkruar vetëm prej tre studentëve nga gjithsejt shtatë studentë.

Ai mendon se kërkesa është udhëzuar në adresë të gabuar dhe se debatet në Kuvend do duhet të mbahen vetëm për çështje serioze.

Drita Kadriu tha se çështja e arsimit të lartë privat, funksionalizimi i tyre dhe çdo aktivitet që lidhet me të është e drejtë e Universitetit Publik. Ne si Komision nuk mund të ndikojmë e as të favorizojmë IPAL e as UP-në kjo varet dhe lidhet drejtpërdrejtë nga vet cilësia e arsimit dhe në këtë rast është e drejtë e UP-së të njeh apo jo vlerën e këtyre institucioneve të arsimit.

Agim Veliu kryetar lidhur me këtë pikë tha se çështja e dhënjes së titujve dhe diplomave është e specifikuar në çertifikatën e akreditimit në pajtim me formatin e aprovuar nga Ministria.

Lidhur me kërkesën e Asociacionit të diplomuarve në IPAL që Komisioni për Arsim , Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport të hap debat në Kuvendin e Kosovës, Komisioni nxorri këtë:

P ë r f u n d i m

Komisioni konstaton se me këtë çështje duhet të merret Ministria e Arsimit dhe Institucionet e Arsimit të Lartë , dhe zgjedhja e problemit të studentëve duhet të rregullohet me dispozitat ligjore në fuqi.

- Shoqata e grave veprimtare kulturore “Luleshkronjat” i është drejtuar Komisionit me kërkesë për mbështetje financiare në vlerë prej 20.000 euro në realizimin e një projekti teator.

Komisioni konsideron se nuk ka kompetenca në realizimin e kërkesave të tilla ngase nuk disponon me fond buxhetor.

Drita Kadriu përsëriti kërkesën që Komisioni t’i drejtohet Kryesisë së Kuvendit që të sigurohet një kompjuter dhe projektor për nevojat e Komisionit në mënyrë që të lehtësohet puna e Komisionit në shqyrtimin dhe në monitorimin e ligjeve.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12,00

Kryetari i Komisionit,
Agim Veliu